



MITROVICA
KOMPANIA UJËSJELLËSI RAJONAL SH.A.
REGIONAL WATER COMPANY J.S.C.
KOMPANIJA REGIONALNI VODOVOD D.D.

D P A

Departamenti për punë administrative

Mitrovicë / Nr.

Duke u bazuar në nenin 8 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, si dhe Udhëzimin Administrativ Nr.07/2017, Kompania Rajonale Ujësjellësi “Mitrovica” Sh.A. në Mitrovicë, shpallë:

K O N K U R S

(Për plotësimin e vendit të lirë të punës punë provuese 6 muaj)

I. Një (1) Shef/e i/e Sigurisë dhe Mbrojtjes në Punë & Objekteve

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Të jetë i/e aftë që me orar të plotë dhe pa kufizime të kryej detyrat e punës,
- Organizon sigurimin e objekteve të Kompanisë dhe hapësirave për rreth, planifikon dhe kontrollon rojet,
- Organizon sigurimin e automjeteve të kompanisë që të mos vijë deri te thyerja e tyre, dëmtimi, vjedhja etj,
- Merr pjesë në organizimin e trajnimit të punëtorëve, lidhur me mbrojtjen në punë dhe për këtë mban evidencë,
- Merr pjesë organizimin e kontrollit periodik të mjeteve të punës , paisjeve dhe kushteve të punës , ku lidhur me këtë mban evidencë,
- Është përgjegjës dhe drejtpërdrejtë obligohet për funksionimin e mjeteve mbrojtëse dhe mbrojtjen ndaj zjarrit sipas lidhshmërisë dhe sigurimit të kompanisë,
- Në rast të vërejtjes së rrezikut nga zjarri apo rreziqe tjera , organizon marrjen e masave më efikase dhe menjëherë kërkon ndihmë në evidentimin e të metave,
- Kujdeset për evidencën e lëndimeve në punë dhe të sëmundjeve, që kanë të bëjnë me punën e punëtorëve,
- Në rast sulmi organizon ndërmarrjen e masave të caktuara konform Rregullores,
- Përgatitë informata dhe planifikon masat mbrojtëse në punë,
- Bënë organizimin e mbrojtjes shëndetësore dhe mbrojtjes në punë,
- Bënë planifikimin dhe mbanë evidence për mjete mbrojtëse dhe higjienike duke u bazuar në Rregullore dhe në afate,
- Mbikëqyrë dhe organizon kontrollet periodike të parapara me Ligj siç janë:
 - kontrolla-sanitaro higjienike;
 - kontrolla dhe servisimi i mjeteve kundër zjarrit;
 - matjet periodike të tokëzimit dhe matjet tjera;
- Raporton te Kryeshefi Ekzekutiv për ndryshime në sigurim fizik dhe me lejen e Kryeshefit i paraqet rastet në organet e PK,
- Kryen çfarëdo detyre tjetër të urdhëruar nga Sekretari të cilit i raporton për ndryshimet gjatë ndërrimeve 24 orëshe,
- Kryen punë tjera juridike sipas urdhrit Udhëheqësit/es dhe Kryeshefit Ekzekutiv.
- Për punën që kryen i përgjigjet Sekretarit/es te Kompanisë.

Kushtet për punësim(edukimi i kërkuar):

- Përgaditja profesionale: Baçelor në Juridik, Menaxhim të Emergjencave ose Siguri dhe shëndet në punë ose në fusha tjera relevante,
- Përvoja e punës 3 vite (e preferueshme),
- Të jetë i certifikuar për siguri dhe shëndet në punë (e preferueshme),
- Përparësi trajnimet e kryera si mbrojtje nga zjarri,
- Të njoh punën me kompjuterike word, Excel etj.

Paga bazë do të jetë 489.95 Euro sipas Rregullores mbi ndarjen e të ardhurave.

Dokumentet e kompletuara të cilat duhet të përfshijnë letrën përcjellëse, biografin tuaj (CV-në), kopjen e diplomës përkatëse e noterizuar, referencat dhe certifikatat e trajnimeve, të mos jetë nën hetime dhe i dënuar apo i dënuar me kusht, letërnjoftimi kopja, dëshmi mbi përvojën e punës (trusti pensional) etj.

Dokumentacioni dorëzohet i fotokopjuar dhe i njëjti nuk u kthehet aplikantëve.

Aplikacionet merren dhe i tërë dokumentacioni i kompletuar dorëzohet në Drejtorin e KRUM-së Rr.,Liçeni,,Suhodoll-Mitrovicë ose në formë elektronike në email- adresën burimet.njerzore@kru-mitrovica

Aplikacionet mund ti merrni edhe në ueb- faqen e kompanisë.

Dokumentet që nuk janë të kompletuara sipas konkursit nuk do të shqyrtohen.

Konkursi do të jetë i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në mjetet e informimit.

Kompania Rajonale Ujësjiellësi “Mitrovica” Sh.A. në Mitrovicë inkurajon kandidatet femra , kandidatet nga grupet minoritare si dhe personat me aftësi të kufizuar të aplikojnë.

KRU ”Mitrovica” Sh. A. Mitrovicë